

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.7643, DATË 2.12.1992, “PËR INSPEKTIMIN SANITAR”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj synon të përcaktojë ndarjen e kompetencave për inspektimin higjieno-sanitar, ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Ushqimit (këtu e në vijim institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë) dhe Inspektoratit Sanitar Shtetëror (këtu e në vijim struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit), sipas legjislacionit specifik rregullues të fushës së veprimtarisë, ndërmjet këtyre dy institucioneve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji mbështet zbatimin e objektivave të parashikuar në programin e qeverisë për shëndetin si një e mirë publike, me faktorë të ndryshëm që ndikojnë në të, përfshirë dhe sigurinë ushqimore ku fokusi është ruajtja e shëndetit publik, nëpërmjet rolit të përcaktuar të institucioneve monitoruese.

Ky projektligj nuk është parashikuar në programin analitik të akteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji nr.7643, datë 2.12.1992, “Për inspektimin sanitar”, i ndryshuar, është ligji bazë i cili rregullon kontrollin për përmbushjen e kushteve higjieno-sanitare në funksion të shëndetit publik, i cili përfshin shumë fusha dhe faktorë që ndikojnë për ruajtjen e tij si një e mirë publike. Në ligjin aktual përcaktohet Inspektorati Sanitar Shtetëror, si organ që kontrollon zbatimin e akteve ligjore, nënligjore sanitare në veprimtaritë e ndryshme që ushtrojnë personat fizikë, juridikë.

Në kuadër të reformës në bujqësi dhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr.9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar, bazuar në rregulloren e BE-së 178/2002, 854/2004, 888/2004 i cili rregullon çështjet e higjienës dhe të sigurisë së ushqimit, krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ushqimit dhe një sistemi të kontrollit formal për ushqimin e njerëzve, të kafshëve me qëllim garantimin e

një nivel të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve, interesit të konsumatorit, ky projektligj synon që të ndajë qartë kompetencat ndërmjet dy institucioneve për kontrollin higjieno-sanitar, në objektet e prodhimit, të ruajtjes, të magazinimit, të transportimit dhe të tregtimit të produkteve ushqimore, si dhe të përditësojë për rrjedhim masat, sanksionet, monitorimin duke bërë shtesat dhe ndryshimet përkatëse në ligjin bazë: ligji nr.7643, datë 2.12.1992, “Për inspektimin sanitar”, të ndryshuar.

Me ndryshimet e propozuara në ligjin bazë për kontrollin higjieno-sanitar, për të siguruar koordinim të plotë me funksionet e ngarkuara për institucione gjithashtu përgjegjëse në inspektimin higjieno-sanitar, ky projektligj synon që subjektet (bizneset) të lehtësohen në aktivitetin e tyre duke qenë objekt kontrolli prej një organi të vetëm inspektues, që do të kushtëzohet në varësi të llojit të veprimtarisë së tyre.

Kryerja e inspektimit higjieno-sanitar në objektet e prodhimit, të ruajtjes, të magazinimit, të transportimit dhe të tregtimit të produkteve ushqimore nga një institucion i vetëm inspektues, nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe të ushqimit për kafshë, shmang mbivendosjen e kompetencave mes dy institucioneve pa cenuar sigurinë dhe cilësinë e produkteve ushqimore, të cilat janë thelbësore për mbrojtjen e shëndetit të popullsisë.

Pavarësisht ndryshimeve të propozuara, institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë nuk do të ketë shtim të numrit të subjekteve që do të inspektojë, por vetëm shtim të një liste verifikimi (*check list*).

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Nga pikëpamja teknike, projektligji është hartuar në 12 nene.

Në nenin 1, të projektligjit, bëhen ndryshimet e nevojshme në lidhje me inspektoratin që mbulon fushën e shëndetit.

Kudo në përmbajtjen e ligjit, fjalët "... inspektorati që mbulon fushën e shëndetit ..." zëvendësohen me "... struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit ..." dhe emërtesa "Drejtoria e Shëndetit Publik" zëvendësohet me fjalët "... Struktura përgjegjëse për shëndetin publik ...".

Në nenin 2 të projektligjit shfuqizohen pikat 5 dhe 6, të nenit 1/1, të ligjit, të cilat rregullonin kuptimin e termave "Hazard/dëmtues" dhe "AZKPK (HACCP)".

Në nenin 3 të projektligjit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje "... Bën përjashtim nga ky ligj inspektimi sanitar në fushën e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, inspektim i cili do të bëhet nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë ...".

Në nenin 4 të projektligjit parashikohen ndryshime lidhur me emërtimin dhe fushën e përgjegjësisë së strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit. Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit është organ ekzekutiv i specializuar që kontrollon zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore sanitare dhe pajis me akt miratimi higjiëno-sanitar subjektet në sektorët publikë dhe jopublikë, sipas përcaktimeve të këtij neni. Është reflektuar sugjerimi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural lidhur me ndryshimin në nenin 4, të projektligjit, të nënndarjes së parë, pas paragrafit të parë, të nenit 10 të ligjit.

Ndryshimet në fushën e përgjegjësisë së strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit kanë të bëjnë me përjashtimin nga kompetenca e saj të inspektimit higjiëno-sanitar në objektet e prodhimit, të ruajtjes, të magazinimit, të transportimit e të tregtimit të produkteve ushqimore, duke parashikuar në këtë mënyrë ndarje të kompetencave ndërmjet institucioneve përgjegjëse për inspektimin higjiëno-sanitar.

Me ndryshimet që propozon ky projektligj, ndarja e kompetencave parashikohet për shkak të ligjit nr.9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", të ndryshuar, i cili parashikon shfuqizimin e disa dispozitave të ligjit nr.7643, datë 2.12.1992, "Për inspektimin sanitar", të ndryshuar, të cilat lidhen me të drejtën që kanë pasur inspektorët sanitarë për të ndaluar prodhimin, ruajtjen, transportimin, tregtimin e produkteve ushqimore që bien në kundërshtim me normat sanitare në fuqi, të drejtën/detyrën e Inspektoratit Sanitar Shtetëror për të marrë mostra të produkteve ushqimore e të pijeve për ekzaminimin e detyrueshëm para qarkullimit të tyre etj.

Rrjedhimisht, me ndryshimet e propozuara, struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit nuk do të ketë kompetenca inspektimi higjiëno-sanitar për produktet ushqimore në objektet e parashikuara për inspektim, sipas ligjit bazë të inspektimit sanitar.

Në këtë mënyrë qartësohen kompetencat për çështjet higjieno-sanitare të produkteve ushqimore, e cila garantohet prej institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, duke garantuar në këtë mënyrë që fusha e kontrollit do të jetë vetëm prej një organi të caktuar.

Si rrjedhojë e ndarjes së qartë të kompetencave ndërmjet institucioneve, në nenin 5 të projektligjit parashikohet shfuqizimi i nenit 12, të ligjit, i cili është ndërmarrë si politikë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për përmirësimin e legjislacionit në fuqi.

Në nenin 6 të këtij projektligji përcaktohen ndryshimet në nenin 13, të ligjit, si më poshtë vijon.

- a) Në shkronjën “c”, fjalët “... si dhe analizën e hazardëve dhe kontrollin në pikat kritike në të gjithë zinxhirin për prodhimin e produkteve ushqimore.” hiqen.
- b) Shkronja “ç” shfuqizohet.

Gjithashtu, në nenin 7 të projektligjit parashikohet ndryshimi i nenit 16, të ligjit, si më poshtë vijon:

“Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit, me miratimin e prokurorit, hyn në çdo kohë në ambiente private, përfshirë edhe banesat, kur ka të dhëna e njoftime për ushtrimin e veprimtarive që rrezikojnë shëndetin e njerëzve, si dhe pa akt miratimi higjieno-sanitar, dhe marrin masat e nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi.”.

Në nenin 8 të projektligjit është parashikuar ndryshimi i nënndarjes së parë të nenit 19, të ligjit, lidhur me kompetencat e inspektorëve që mbulojnë fushën e shëndetit, të cilët kanë të drejtë të ndalojnë prodhimin, ruajtjen, transportimin, tregtimin e produkteve kozmetike në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në legjislacionin përkatës dhe normat sanitare, duke hequr kompetencat e tyre për të ndaluar prodhimin, ruajtjen transportimin, tregtimin e produkteve ushqimore, pijeve, produkteve dhe nënprodukteve blegtorale të përpunuara ose jo në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në legjislacionin përkatës dhe normat sanitare.

Rrjedhimisht, ndahen qartë kompetencat ndërmjet institucioneve shtetërore që disponojnë mjetet dhe kapacitetin teknik për një kontroll sa më efektiv higjieno-sanitar në varësi të aktivitetit të subjekteve.

Ndryshimet e propozuara në ndarjen e kompetencave diktojnë ndryshimet, gjithashtu, në kreun III, të ligjit bazë, duke parashikuar konkretisht:

- Në elementet që përbëjnë kundërvajtje administrative sanitare shfuqizohen dhe nuk do të konsiderohen shkelje sanitare, sipas nenit 10,

të këtij projektligji si: “falsifikimet ose maskimet në teknologjinë e prodhimit, ruajtjes, transportit e tregtimit të produkteve ushqimore kur këto ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut”; “mosrespektimi i kushteve të prodhimit, sipas kërkesave sanitare që përmban standardi shtetëror ose kushti teknik i produktit ushqimor; “dhe i AZKPK-së (HACCP)”; “tregtimi i produkteve ushqimore jashtë vendeve të lejuara ose pa leje shëndetësore”; “përdorimi i ujërave të zeza për ujitjen e zarzavateve që konsumohen pa përpunim termik paraprak”.

Këto shkelje kanë si burim mosrespektimin e rregullave që lidhen me cilësinë e ushqimit, praktikat në prodhimin/tregtimin e produkteve ushqimore etj., të cilat vlerësohen prej institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

Me shfuqizimin e kompetencave të strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit për kryerjen e inspektimeve në objektet e prodhimit, të ruajtjes, magazinimit, transportimit e tregtimit të produkteve ushqimore, në nenin 11 të këtij projektligji parashikohet që të hiqet dënimi i parashikuar me gjobë për ato elemente që përbëjnë kundërvajtje administrative sanitare lidhur me ushqimin. Në nenin 11 parashikohen ndryshimet në pikën 4, të nenit 27, të ligjit, si më poshtë vijon:

- a) Në nënndarjen e parë hiqen numrat “2” dhe “3”.
- b) Në nënndarjen e dytë hiqet numri “12”.
- c) Në nënndarjen e tretë hiqet numri “5”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit dhe institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk ka efekte financiare.

KËSHILLI I MINISTRAVE